

Grumbullimi i diferencuar tek Ce.R.D.

Shenja Ce.R.D. do të thotë Qendra e Grumbullimit të Diferencuar. Është një hapësirë e qarkuar dhe e ruajtur ku dërgohen disa mbeturina që nuk mblidhen derë më derë

Për të hyrë në Ce.R.D.

- sillni dokument identiteti
- fusni mbeturinat brenda kontejnerëve duke ndjekur udhëzimet e personelit
- mos merrni mbeturina që ndodhen brenda Ce.R.D. -it
- mos lini materiale jashtë Ce.R.D. -it

Pranë Ce.R.D. -it grumbullohen

- **Kartonë:** vetëm ambalazhe kartoni apo kartonçina (për shembull kutia të vogla e të mëdha).
- **Xhama:** shishe dhe fletë xhami në përgjithësi, xhama dritarësh të shkëputura nga pjesa anësore prej plastike.
- **Metal:** në përgjithësi hekur, termosifone prej gize, rrjeta metalike, kanoçe alumini ose të veshura hermetikisht, kutia alumini, shishka spray prodhimesh për higjienën personale dhe të shtëpisë të boshatisura.
- **Elektroshtëpiake:** lavatriçe, larëse enësh, frigoriferë, ngrirës, kondicionerë, termokonvertër, televizorë, monitorë, kompjuter, printerë, celularë, fshesë me korrent, hekur hekurosje, robot kuzhine.
- **Dru:** mobilie në përgjithësi, trungje, sirtarë prej druri, tallash.
- **Bimore:** tufa bari, degë peme, mbeturina krasitjeje, dhera.
- **Inerte:** mbeturina të përziera nga shembjet si dhe qeramikë, baltë e pjekur, porcelane.
- **Ambalazhe Plastike:** celofan, najlon, polisterol ambalazhimi, mbajtëse, thasë dhe çanta plastike, shishe, kuti dhe sirtarë plastikë.
- **Objekte prej Plastike të Fortë:** mobilie oborri si tavolina, karrige dhe karrige të shtrira tërësisht plastike, vaska, legenë, kova plastike, ujitëse dhe vazo (jo prej pvc); veshje damizhanësh plastike, tanikë të pastër dhe të paetiketuara T&F prej plastike.
- **Goma:** Goma makinash dhe motorësh, biçikletash dhe motorinosh.
- **T/F spray e jo spray:** Shishka spray boje, pesticide, herbicide, antindryshk, kova boje, kutia ngjitëseje.
- **Neon:** llamba të djegura dhe nenë të konsumuar.
- **Bateri:** bateri të konsumuara për makinat dhe automjetet.
- **Vaj bimor:** vaj për skuqje dhe për përdorim ushqimor.
- **Vaj Mineral:** vaj për makina.
- **Pila:** pila të zgjatura (p.sh. për elektrikë dore dhe radio), pila kopsë(p.sh. për ora), pila drejtkëndore, bateri për celularë.
- **Ilaçe të skaduar:** flakonë për injeksionet, dizifektues, shurupe, tableta, pluhura (pa konfeksionin prej letre).
- **Kartuça dhe Toner:** kartuça dhe toner për printerë të mbaruara.

Ce.R.D në shtëpi

Shoqëria Priula grumbullon në shtëpi mbeturinat bimore me shumicë, mbeturina me përmasa të mëdha dhe pajisje elektrike dhe elektronike.
Shërbimi bëhet me pagesë dhe duhet të prenotohet duke telefonuar në një nga Ekosportelet ose duke dërguar një fax në numrin 0422 911829.

Grumbullimi i diferencuar...

...është i detyruar me ligj prandaj është nën vëzhgim!

Policët e ambientit si dhe operatorët kontrollojnë vazhdimisht sjelljen e përdoruesve kur hedhin mbeturinat e tyre. Kur vërehen shkelje paralajmërohen dhe pas disa vërejtjesh të përsëritura u vihet gjobë. Për më tepër janë nën vëzhgim familjet që kanë një sasi vjetore mbeturinash çuditërisht të ulët në krahasim me numrin e pjestarëve të familjes.

Ligji ndalon që:

Të digjen mbeturina të çfarëdo lloji

Është një mënyrë eliminimi e pa autorizuar dhe ndot ambientin. Raste të tilla dënohen me gjoba.

Të braktisen mbeturina të çfarëdo lloji

Një mbeturinë e braktisur lëshon substanca helmuese në hapësirë dhe në ajër. Bëhen kontrole falë përdorimit të mikrotelekamerave.

Të futësh mbeturinat e tua në kontejnerët e të tjerëve

Kush kërkon të çlirohet në këtë mënyrë nga mbeturinat tregon se nuk e respekton ambientin dhe bashkëqytetarët e tij që paguajnë rregullisht shërbimin e grumbullimit!

Të aktivizosh shërbimin e grumbullimit të mbeturinave:

Kush duhet ta aktivizojë shërbimin:

duhet ta aktivizojnë grumbullimin e mbeturinave të gjitha familjet, entet dhe ndërmarrjet që, në territorin e përbashkët, zënë, mbajnë ose zotërojnë lokale dhe/ose zona të zbuluara. Zona dhe lokale mund të përdoren ose thjesht të jenë të predispozuar për përdorim nga banesa civile. Një zonë ose një lokal përcaktohen si të predispozuar kur janë të pajisura ose kanë qoftë edhe vetëm një nga lidhjet e gazit, ujit, energjisë elektrike.

Ku aktivizohet:

shërbimi i grumbullimit aktivizohet pranë njërit nga Ekosportelet. Për të nënshkruar formularët e shërbimit mund të paraqitet në sportel:

- titullari i përdorimit me dokument identiteti të vlefshëm
- një person i autorizuar me dokumentin e tij të identifikimit, me një kopje të dokumentit të identitetit të titullarit të përdorimit dhe autorizimin e nënshkruar prej tij

Dokumentet e nevojshëm për përdorime shtëpiake:

në momentin e aktivizimit duhet të sillni

- kodin fiskal të titullarit të përdorimit
- kontratën e qirasë dhe shitblerjes së pasurisë së paluajtshme

Informacionet e nevojshme:

në momentin e aktivizimit ndër të tjera duhet të jepni

- rrugën dhe numrin e banesës së përdoruesit
- emrin e pronarit të përdorimit
- sipërfaqjen tërësore të përdorimit
- datën duke filluar nga ajo e vënjes në dispozicion (datën kur janë bërë lidhjet e ujit, gazit apo energjisë elektrike ose kur janë vendosur mobilimet e para)

Kontejnerët:

në momentin e aktivizimit çdo përdorues i ri merr qeset dhe, merr hua (huapërdorje për shfrytëzim), kontejnerët ku do të vendosë llojet kryesore të mbeturinave.

Të mbyllësh shërbimin e grumbullimit të mbeturinave urbane

Ku të drejtohesh::

për të mbyllur shërbimin e grumbullimit të mbeturinave duhet të drejtohesh në një nga Ekosportelet. Për të nënshkruar formularët e mbylljes së shërbimit mund të paraqiten pranë sportelit:

- titullari i përdorimit me dokument identiteti të vlefshëm
- një person i autorizuar me dokumentin e tij të identifikimit, me një kopje të dokumentit të identitetit të titullarit të përdorimit dhe autorizimin e nënshkruar prej tij

Dokumentet e nevojshëm për përdorime shtëpiake:

në momentin e mbylljes së shërbimit duhet të sillni:

- kopjen e prishjes së kontratës së qirasë dhe të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme
- adresën e re të titullarit të përdorimit

Kontejnerët:

në momentin e mbylljes së kontratës kontejnerët dorëzohen të boshatisur dhe të pastruar. Ju këshillojmë të kontrolloni që kodet në faturat e marra t'i korrespondojnë atyre të kontejnerëve që ktheni.

Humbje, vjedhje apo prishje e kontejnerëve

Nëse një kontejner deri në 120 litra vidhet ose humbet duhet të paraqiteni në një nga Ekosportelet. Aty mund të tërhiqni menjëherë një kontejner të ri. Për kontejnerët nga 240 litra e sipër duhet të kontaktoni Ekosportelin për furnizimin.

Nëse kontejneri deri 120 litra prishet duhet të paraqiteni në një nga Ekosportelet së bashku me kontejnerin e prishur që doni të ndërtoni. Aty mund të tërhiqni menjëherë një tjetër. Për kontejnerët nga 240 litra e sipër duhet të kontaktoni Ekosportelin për zëvendësimin.

Shërbime të tjera për përdoruesit shtëpiake

Amiant (shërbim me pagesë)

Shërbimi parashikon grumbullimin, transportin dhe eliminimin e sasive të vogla të materiale që përmbajnë amiant. Për informacione drejtohuni çdo Ekosporteli ose Zyrës së Shërbimeve Shtesë të Shoqërisë (tel. 0422 916690 e-mail amianto@priula.it).

Zhdukja e mijve dhe dezinfektimi (shërbim me pagesë)

Shërbimi që parashikon dezinfektimin e parazitëve të pemëve dhe bimëve (larvën e pishës, krimbin amerikan, etj) të insekteve dhe kafshëve si mushkonjave, grerëve, grenzave dhe brerësve. Shërbimi bëhet në bashkëpunim me ndërmarrjet sanitare lokale. Për informacione drejtohuni çdo Ekosporteli ose Zyrës Publike të Gjellbërimit të Shoqërisë (tel.0422 916694, e-mail verde@priula.it).

Grumbullimi i diferencuar

Përdorues shtëpiakë



Kontejnerët e rinj

S

THATA
TË PARECIKLUESHME

Kontejneri jeshil
me sinjal

Kontejneri gri
me sinjal

Nga



Tek



**Grumbullim derë më derë
1 HERË NË JAVË**

Kontejneri i ri i thatave të parecikliueshme do t'u jepet përdoruesve të rinj dhe kujdo që zëvendëson kontejnerët e dëmtuar.

VG

BIMORE

Thasë të
bardhë

Kontejnerë
bezhë të ajrosur

Nga



Në



**Grumbullim derë më derë
1 HERË NË JAVË nga prilli në tetor
1 HERË ÇDO 2 JAVË nga nëntori në mars**

Dorëzimi i kontejnerit të bimëve do të lajmërohet nga Shoqëria nëpërmjet një letre. Shërbimi i ri do të jetë me dëshirë dhe me pagesë.

Grumbullimi derë më derë

S

THATA
TË PARECIKLUESHME

**Gese transparente gri ose jeshile
Kontejner gri ose jeshil**

**Grumbullim derë më derë
1 HERË NË JAVË**

- fusni mbeturinat në qese transparente të disponueshme në Ekosportel.
- nxirreni jashtë kontejnerin me kapakun e mbyllur
- nxirreni jashtë kontejnerin vetëm nëse është i mbushur plot
- mos hidhni materiale sipër ose afër kontejnerit
- mos i ngjishni tek mase mbeturinat



ÇFARË TË HIDHNI NË KONTEJNER:

- kutia për pije dhe ushqime në kartonë të plastifikuar
- pjata, gota, lugë e pirunë plastikë
- letër oleate ose të plastifikuar
- panolina dhe letra thithëse
- llamba me fill
- stilolapsa dhe penela
- lodra, zbukurime dhe sende shtëpiake plastike
- thasë për fshesa me korrent
- kompakt disqe, kaseta muzike, videokaseta apo mbështjellëset e tyre plastike
- mbajtëse dokumentesh apo dosje plastike
- objekte dhe tuba gome
- dorashka gome
- kozmetikë
- sfungjerë sintetikë
- brisqe dhe krehra plastikë
- shiringa të mbyllura me tapë dhe qese për dializë stomatizantë
- thasë, qese, çanta apo mbështjellëse najloni të ndotura (nëse janë të pastra shiko AMBALAZHE PREJ PLASTIKE TË BUTË)

U LAGËSHTA

**Gese e Biodegradueshme
Kontejner kafe**

**Grumbullim derë më derë
2 HERË NË JAVË**

- hidhni mbeturinat në qeset ebiodegradueshme që jepen tek Ekosporteli
- mos i përdorni qeset e plastikës as për të mbrojtur përbrenda kontejnerin që do të nxirreni jashtë
- mos e nxirreni jashtë koshin e mbeturinave nën lavaman (prej 6,5 litri) që shërben vetëm për grumbullimin e mbeturinave në shtëpi
- nxirreni jashtë kontejnerin me kapakun e mbyllur
- mos hidhni materiale sipër ose afër kontejnerit



ÇFARË TË HIDHNI NË KONTEJNER:

- mbeturina frutash, zarzavatesh dhe ushqimesh
- lëvozhga veze
- kocka të vogla
- mbeturina peshku dhe molusqesh
- mbetje ose qese kafeje apo çaji
- bimë dhe lule të këputura
- shamia apo peceta letre të ndotura
- shtroje të vogla për kafshë shtëpiake me jashtëqitjet e tyre
- hirin e fikur të oxhaqeve
- mbyllëse prej tape

VG BIMORE

Thasë të bardhë të thurur ose Kontejner bezhë

**Grumbullim derë më derë
1 HERË NË JAVË
Nga prilli në tetor**

**1 HERË ÇDO 2 JAVË
Nga nëntori në mars**



- Hidhni mbeturinat brenda thesit ose kontejnerit

Për atë që ka kontejner:

- nxirreni jashtë kontejnerin me kapakun e mbyllur
- mos hidhni materiale mbi apo pranë kontejnerit

Për atë që ka thes:

- përdorni vetëm thasë të shënuara tek Ekosporteli
- nxirreni jashtë e shumta 3 thasë të bardhë ose 2 thasë të bardhë + 1 vandak (me përmasat e një thesi) ose 1 thes të bardhë + 2 vandakë ose 3 vandakë me një thes të bardhë ne mes).
- lidhni me kujdes vandakët
- mbështetini vandakët pranë thasëve tuaj të bardhë pa i futur brenda

ÇFARË TË HIDHNI NË KONTEJNER:

- degë të prera, krasitje pemësh dhe gardhe të lidhur në vandakë
- kositje bari dhe lule të këputura
- bimë pa dhera
- mbeturina bimore të kopshtit

C LETËR

Kontejner i verdhë

**Grumbullim derë më derë
1 HERË ÇDO 2 JAVË**



- hidhni në kontejner mbeturina të shpërbëra, pa përdorur qese
- mos hidhni letra të ndotura
- nxirreni jashtë kontejnerin me kapakun e mbyllur
- mos hidhni materiale mbi apo pranë kontejnerit

ÇFARË TË HIDHNI NË KONTEJNER:

- gazeta dhe revista
- fletë dhe fletore
- konfeksione kartoni (p.sh. të makaronave, orizit ...)
- qese prej letre
- libra
- kartonë të palosur

V XHAMA PLASTIKË KANOÇE

Kontejner blu

**Grumbullim derë më derë
1 HERË ÇDO 2 JAVË**



- hidhni në kontejner mbeturina të shpërbëra, pa përdorur qese
- hidhni në kontejner mbeturina të pastra dhe plotësisht të zbratur
- ngjeshini kanoçet dhe kutiat prej plastike për t'u zvogëluar volumin
- mos i përdorni qeset plastike as për të mbrojtur nga brenda kontejnerin
- nxirreni jashtë kontejnerin me kapakun e mbyllur
- mos hidhni materiale mbi apo pranë kontejnerit

ÇFARË TË HIDHNI NË KONTEJNER:

- shishe xhami
- kavanoza apo enë xhami
- gota prej xhami
- shishe plastike uji dhe lëngjesh
- bidonë plastike detergjentesh, detersivësh dhe shampoje
- kutia plastike kosi
- mbajtëse të formëzuara plastike ose polisteroli vezësh, ushqimesh dhe sendesh të ndryshme
- kanoçe alumini (për sh. pijesh)
- kutia dhe mbajtëse me veshje hermetike për ushqime (salca, ton, etj.)
- tapa dhe kapakë metalikë
- letër hermetike dhe konserva alumini
- tubete metalikë të boshatisur (për majonezë, bojë këpucësh, etj.)
- shishka spray prodhimesh për higjienën personale dhe të shtëpisë të boshatisura

PM AMBALAZHE PREJ PLASTIKE TË BUTË

Qese e kaltër e tejdukshme ose qese tjetër transparente (përveç asaj me mbishkrimin të thata të paraciklueshme)

**Grumbullimi pranë Qendrës së
Grumbullimit të Diferencuar (Ce.R.D.)**



- mos fusni ambalazhe të ndotura (për shembull filma të ndotur me ushqime)

ÇFARË TË HIDHNI NË QESE:

- qese, çanta, konfeksione najloni dhe plastike për ushqimet
- rrjeta frutash dhe zarzavatesh
- mbështjellëse për konfeksione lëngjesh apo revistash
- filma dhe shirita
- qese dhe kutia plastike për konfeksionimin e rrobave
- lidhëse pakosh

Tarifa

Nëpërmjet tarifës Shoqëria financon administrimin e mbeturinave urbane: grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe riciklimin e mundshëm.

Kush e paguan tarifën?

Tarifën e paguajnë të gjitha familjet, entet dhe ndërmarrjet që, në territorin e Shoqërisë, zënë, mbajnë dhe zotërojnë lokale dhe/ose zona të zbuluara. Zonat dhe lokalet mund të jenë të përdorshme ose thjesht të predispozuara për përdorim banesash civile, për prodhimin e të mirave materiale dhe/ose shërbimeve, për shitjen e të mirave materiale dhe/ose shërbimeve. Një zonë apo një lokal quhen të predispozuara kur janë të pajisur ose kanë qoftë edhe një prej lidhjeve të gazit, ujit, energjisë elektrike.

Për përdoruesit familjarë (familjet)

Kuota fikse

(taksë e barabartë për të gjitha familjet)

+

Kuota e ndryshueshme

(numri i zbrazjeve të kontejnerit të mbeturinave të thata të pareciklueshme X koston e një zbrazjeje)

=

Tarifa e përgjithshme në ngarkesë të çdo familjeje

Për banesat e përbashkëta

Për atë që ka kontejner të thatave të pareciklueshme të përbashkët: kuota fikse mbetet e njëjtë për çdo familje, ndërsa ajo e ndryshueshme përftohet duke shumëzuar numerin e zbrazjeve të kontejnerit me koston e një zbrazjeje.

Kjo kuota përpjestohet pastaj mes të gjithë banorëve, në bazë të numrit të anëtarëve të familjes. Kostoja e një zbrazjeje rritet me volumin e kazanit të banesës së përbashkët.

Vini re: në lidhje me kuotën e ndryshueshme të tarifës, të gjithë përdoruesit janë të detyruar të paguajnë një numër minimal zbrazjesh siç e parashikon rregullorja e Shoqërisë që mund të shkarkohet tek siti www.consorziopriula.it

Fatura e dërguar çdo përdorimi mund të paguhet:

- pranë bankës së treguar në faturë pa asnjë shpenzim vetëm duke paraqitur fletën postare bashkangjitur faturës
- pranë zyrave postare nëpërmjet fletës postare bashkangjitur faturës ose nëpërmjet sitit www.poste.it
- nëpërmjet debitimit direkt në llogarinë rrjedhëse që aktivizohet duke plotësuar dhe dorëzuar pranë bankës suaj formularin me të dhënat e vendbanimit për bankën që mund ta tërhiqni tek Ekosporteli.

Çfarë ju leverdis të bëni?

Kini kujdes mbeturinat e thata të pareciklueshme!

Mbeturinat që ndosin më tepër quhen të thata të pareciklueshme. Bëhet fjalë për materiale që duhet të eliminohen. Të eliminosh kushton shumë më tepër se të riciklosh e për këtë arsye kuota e ndryshueshme e tarifës lidhet me prodhimin, grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave të pareciklueshme.

Sa më pak të prodhosh aq më pak paguan.

Secili kontejnerin e vet

Kini kujdes që të mos shkëmbeni kontejnerët! Kontejnerët e dorëzuar pranë Ekosporteleve kanë kode. Vëri një shenjë kontejnerëve tuaj për të mos i ngatërruar me ata të komshive.

Ulje të tarifave për përdoruesit shtëpiakë

Janë parashikuar ulje të tarifës për rastet e mëposhtme:

- **kompostazhin shtëpiak** për këdo që bën në shtëpi të tij kompostazhin (dekompozimin)

Për të kërkuar uljen është e nevojshme të plotësohet një formular pranë uno degli Ecosportelli.

Nxirri jashtë Kontejnerët ...

Kur?

Një natë para ditës së grumbullimit të treguar tek Ekokalendari (shërbimi fillon në 3 të natës).



Si?

Pa qese të jashtme dhe me kapakun mbyllur.



Pas zbrazjes kapakët e kontejnerëve lihen hapur për të treguar se shërbimi i grumbullimit është kryer.

Nëse zbrazja nuk është kryer mund të njoftoni tek çdo Ekosportel.

